




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të nenit 4 pika 1 paragrafi 1.15 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 30 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në takimin e mbajtur më 2 shkurt 2016, e miraton këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (03/2016)
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.2008/02 PËR UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ (2008/02) për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Neni 2

Tek neni 6 [*Mbledhja e taksave, efekti i mos pagesës*], paragrafi 6.5 pas përfundimit të fjalisë “Nëse ato nuk paguhen deri në datën përfundimtare, gjykata do të hedh poshtë parashtrësën për të cilën nuk janë paguar taksa” shtohet fjalia “përveç për padi civile për të cilat do të aplikohet neni 253 [*Përmbajtja e padisë*], paragrafi 253.5 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.”

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Prishtinë 02/02/, 2016

